ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i Prokurimit: **651-26-9017-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **'' Furnizim me lëndë djegëse dru "**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Evergreen Timber SH.P.K. - 812051770
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)
Rruga Zllashi I Vogël, pn
(Adresa)
Prishtinë *10000*
(Vendi) *(Kodi postar)*
+38344737579 *N/A*
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*
Blerim Vitija
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
info.evergreentimber@gmail.com
(Adresa elektronike)

13.11.2026

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontrate – 16.10.2026 Hapja e planifikuar - 10.11.2026 Kerkesa për ri shqyrtim 30.10.2026 Vendmi i AK -se 03.11.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja e planifikuar - 16.11.2026, pas njoftimit mbikorrigjimin e gabimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ **Jo** ☒

OE Evergreen Timber SHPK , ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim më 30.10.2026, duke kundërshtuar pesë çështje të kritereve të përzgjedhjes. Vendimi i AK-së i datës 03.11.2026 ka aprovuar pjesërisht kërkesen e Evergreen, duke shpallur korrigjime në dosje ne mënyrë lajthitese vetëm duke publikuar njoftim mbi korrigjimine gabimit por jo edhe ndryshimin e kritereve kualifikuese.
Në formularin B54, pragu numerik 8,000 m² mbetet, noterizimi për marrëveshjet e pajisjeve hiqet, ndërsa depoja për OE jashtë Gjilanit kërkohet në qytetin e Gjilanit. B54 e zgjat afatin e ofertimit nga 10.11.2026, ora 14:00, në 13.11.2026, ora 14:00, që i bie vetëm 3 ditë dhe se data e përgatitjes e shënuar në B54 është 16.10.2026.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji për prokurim publik, nr 04/L-042 i amandamentuar meligjet tjera

- Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 25 - Trajnimi i Zyrtareve të Prokurimit
- Neni 28 - Specifikimet teknike
- Neni 51 - Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
- Neni 52 - Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
- Neni 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 108/A -Zgjidhja preliminare e mos marreveshjeve
- Neni 130 – Ndikimi i paligjeshem

Rregullorja me nr. 001/2022, per Prokurim Publik

- Neni 25 Kriteret e përzgjedhjes
- Neni 97 Shkeljet e rënda

Ligjit për Pyjet atije me nr. 08/L-113

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Operatori Ekonomik **EVERGREEN TIMBER SH.P.K.**, në cilësinë e palës së interesuar në aktivitetin e prokurimit me nr. **651-26-9017-1-1-1**, me titull “Furnizim me lëndë djegëse

dru", kundërshton Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjilanit, të datës 03.11.2026, me të cilin kërkesa jonë për rishqyrtim është aprovuar vetëm pjesërisht ku përmes njoftimit mbi korrigjimin e gabimit nuk ka publikuar korrigjimet dhe perseri përmes kerkesavekunderligjore tenton te realizon hapjen e ofertave ne mënyrë qe te lidhe kontrate me kompanine e percaktuaktuar paraprakisht.

Pas shqyrtimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues, Formularit B54 për korrigjimin e gabimeve dhe dokumentacionit përkatës të tenderit, konstatojmë se korrigjimet e ndërmarra nuk i kanë adresuar në mënyrë të plotë dhe të argumentuar pretendimet tona ankimore ku disa prej kritereve të kontestuara vazhdojnë të mbeten në fuqi, ndërsa për pretendimet e tjera Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë përgjigje të veçanta, të mbështetura në fakte, analiza teknike dhe dispozita konkrete ligjore.

Veçanërisht shqetësues është fakti se Autoriteti Kontraktues ka riprodhuar pretendimet e operatorëve ekonomikë në përmbajtjen e vendimit, por nuk ka bërë vlerësim individual për secilin pretendim dhe nuk ka arsyetuar domosdoshmërinë e kritereve që ka vendosur të mbajë në fuqi dhe me këto veprime ka konsumuar shkelje te nenit 108/A te LPP-se, ku nuk e ka trajtuar pretendimin ne baze te asaje qe është kerkuar ne kerkese për r i shqyrtim dhe se kombinimi i kërkesave për kapacitete të caktuara teknike, numër fiks të punëtorëve, konfigurime specifike të mjeteve transportuese dhe vendndodhje të detyrueshme të depos krijon rrezik real për kufizimin e konkurrencës dhe trajtimin e pabarabartë të operatorëve ekonomikë. Këto kritere mund të krijojnë përparësi për operatorë me struktura të caktuara organizative, pa u dëshmuar se karakteristikat e kërkuara janë objektivisht të domosdoshme për realizimin e kontratës.

Qëllimi i ankuesit nuk është shmangia e kërkesave të ligjshme për realizimin e kontratës, por sigurimi që ato të jenë objektive, proporcionale, jodiskriminuese dhe drejtpërdrejt të lidhura me natyrën e furnizimit**.**

Për këtë arsye, duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, në parimet e konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë, si dhe në praktikën relevante të Organit Shqyrtues të Prokurimit, paraqesim në vijim pretendimet ankimore, të shoqëruara me argumentet faktike, bazën ligjore dhe provat përkatëse.

Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që secili pretendim të shqyrtohet në mënyrë individuale dhe në ndërlidhje me efektin e përgjithshëm të kritereve të tenderit mbi konkurrencën, si dhe të urdhërohen korrigjimet e nevojshme në rast të konstatimit të shkeljeve ligjore.

<u>Pretendmi ankimore 1.</u>

Në faqet 2–3 të vendimit të 03.11.2026, AK ka riprodhuar përmbajtjen e pretendimeve të Evergreen, në faqen 7 ka përmendur si korrigjime licencën dhe depon. Nuk jep vendimmarrje të dallueshme, pranim apo refuzim dhe arsyetim për kërkesën e 20 punëtorëve, kamionët e Aneksit 8 dhe pretendimin e pestë mbi praktikën e mëparshme. Për depon, ndryshimi formal në B54 nuk shpjegon pse duhet të ruhet lokacioni në qytetin e Gjilanit.

Pretendimi fillestar i Evergreen	Çfarë dokumentohet nga vendimi/B54	Çfarë mungon
Licenca e shfrytëzimit pyjor	Vendimi e shënon për korrigjim; B54 e marrë në shqyrtim nuk e përmban tekstin e korrigjimit.	Konfirmimi i versionit përfundimtar; nuk kërkohet heqje sërish nëse është larguar.
20 punëtorë	Nuk jepet zgjidhje individuale.	Analiza e ngarkesës dhe arsyetimi për pragun fiks.
Kamionë, vinça, tonazhe dhe pajisje	B54 heq noterizimin, jo karakteristikat e Aneksit 8.	Analiza e rrugëve, porosive dhe mjeteve funksionalisht ekuivalente.
Depo 20–30 km	B54 e ndryshon në depo/paramarrëveshje brenda qytetit të Gjilanit.	Arsyetim pse lokacioni lokal është i nevojshëm për dorëzim në afat.
Praktika e mëparshme e ekspertit/zyrtarit	Vendimi nuk e shqyrton veçmas.	Konfirmim i raportit, rolit dhe përgjigje juridike pa supozim konflikti interesi.

Në bazë të nenit 108/A, një përgjigje e përgjithshme se të gjitha pretendimet janë shqyrtuar nuk zëvendëson arsyetimin faktik dhe juridik për secilin pretendim prandaj kërkojmë që OSHP, të konstatojë mangësinë e arsyetimit dhe të shqyrtojë në themel kriteret e mbetura në kontest, jo vetëm të kthejë lëndën për një përgjigje formale.

Pretendmi ankimore 2.

OE Evergreen ka kundërshtuar kërkesën për minimum 20 punëtorë në një kontratë furnizimi periodik me dru. AK nuk ka paraqitur në vendim analizë të tonazhit ose vëllimit sipas porosive, numrit të shkollave për ditë, punës së ngarkim-shkarkimit, përdorimit të mekanizimit dhe kohës së nevojshme për ekzekutimin e porosive. Kapaciteti mund të provohet me plan organizativ, ekip të mjaftueshëm, mjetet dhe afatin e dorëzimit. Nuk kundërshtohet e drejta e AK-së të kërkojë personel të mjaftueshëm; kundërshtohet numri fiks pa analizë objektive, prandaj aplikimi i numrit prej 20 punetoreve për një kontrate kornize me kohezgjatje prej 36 muajve ka barre për kompanine dhe nuk mundet AK, te fus kompanine ne maredhene kontraktuale me te paktën 20 persona, kja kerkese është apsurde, është kundërligjore dhe tipike favorizuese !

Kjo kerkese detyrimisht dueht te riformulohet kriteri në kapacitet funksional të dokumentuar nëse mbahet minimumi 20, AK të ofrojë analizë konkrete të nevojës dhe alternativave më pak kufizuese.

Pretendmi ankimore 3.

Në kërkesën paraprake, OE Evergreen, ka kundërshtuar konfigurimet e mjeteve që figurojnë në aneksin 8, si, kamion kiper me vinç 20–28 tonë, kamion kiper me vinç 3–8 tonë, kamion me kran 18–28 tonë, si dhe traktor me kabinë dhe pajisje të tjera të listuara. Këto janë kategori që ankuesi i ka kundërshtuar si paketë të mjeteve, numrat dhe termat duhet të lexohen së bashku me Aneksin 8 zyrtar.

Për furnizim me dru në shkolla dhe institucione, specifikimi i mjeteve duhet të lidhet me funksionin: transport i sigurt, qasje në oborre, shkarkim pa dëmtim, kapacitet për porosinë dhe respektim afati.
AK nuk ka publikuar në vendim: listë të pikave të furnizimit ku nevojitet çdo konfigurim, kufizimet e rrugëve apo oborreve, peshën ose sasinë maksimale për një porosi, arsyen pse vinçi kërkohet në konfigurimin e caktuar dhe nuk mjafton mjet alternativ ose shkarkim me pajisje tjetër, arsyen pse kërkohen njëkohësisht këto tipologji të veçanta dhe jo një kombinim funksional ekuivalent.

Kjo çështje nuk zgjidhet nga formualri B54, ai zëvendëson vetëm kërkesën e noterizimit të marrëveshjes së shfrytëzimit me nënshkrim të të dy palëve. Heqja e noterizimit është korrigjim real, por nuk është përgjigje ndaj konfigurimeve, vinçave dhe tonazheve që Evergreen kundërshtoi dhe në faqen 7, të vendimit nuk jepet arsyetim i veçantë për kamionët, prandaj kërkojmë nga OSHP të urdhërojë rishikimin dhe korrigjimin e aneksit 8 në mënyrë që kriteret të fokusohen te mjetet transportuese - shkarkuese të përshtatshme, të provohen me pronësi, qira ose marrëveshje të ligjshme, të lejohen kombinime teknikisht ekuivalente dhe çdo kufizim tonazhi - vinçi të mbështetet me analizë të dokumentuar.

Aneksi 8. LISTA E PAJISJEVE DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM

Vërejtje: Mbetet obligim i Kontraktorit që, përveç pajisjeve dhe makinerive të listuara më poshtë, të sigurojë edhe pajisje dhe makineri tjera për të cilat kontstohet (nga Autoriteti Kontraktues apo vet Kontraktori) se janë te nevojshme për ekzkekutimin e punëve sipas sasisë, cilësisë dhe dimaikës së kontraktuar.

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia minimale e kërkuar (cope) (Ofertuesi mund te ofroje edhe sasi me te madhe)	Sasia që ofron ofertuesi
1	Kamion Kiper me Vinq pasha totale me ngarkese 20-28	1	
2	Kamion Kiper me Vinq, pasha totale me ngarkese 3-8 T.	1	
3	Kamion me Kran, pesha totale me ngarkese 18-28 T.	1	
4	Kamion me Vinq, pesha totale me ngarkese 24-35	1	
5	Traktor me kabin	1	
6	Motorre dore	6	

Praktika e mëparshme e OSHP-së lidhur me kriteret kufizuese për mjetet transportuese

Praktika e OSHP-së – Vendimi nr. 2026/0498, datë 18.08.2026

Operatori Ekonomik EVERGREEN TIMBER SH.P.K ju njofton se për kërkesa të ngjashme kufizuese lidhur me tonazhin, vinçat dhe karakteristikat e mjeteve transportuese, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka trajtuar më parë ankesën e të njëjtit Operator Ekonomik kundër Komunës së Shtimes, në lëndën **OSHP nr. 2026/0498**, për aktivitetin e prokurimit nr. **617-26-4772-1-1-1**, me objekt furnizimin me dru për institucionet komunale.

Në Raportin e Ekspertit Shqyrtues nr. 2026/0498, datë 27.07.2026, faqja 15, te përgjigjja ndaj Pretendimit Ankimor nr. 3**,** eksperti Butrint Shabani ka konstatuar se kërkesa për dy kamionë me vinç, me karakteristika të veçanta dhe tonazh minimal prej 26 dhe 28 tonësh, nuk ishte arsyetuar me analizë objektive nga Autoriteti Kontraktues.

Eksperti ka vlerësuar se furnizimet mund të realizohen edhe me mjete me tonazh më të ulët dhe se vendosja e karakteristikave të pajustifikuara mund të kufizojë konkurrencën, në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Për këtë arsye, eksperti e ka vlerësuar TË BAZUAR pretendimin ankimor lidhur me kamionët dhe ka rekomanduar largimin ose ndryshimin e kriterit dhe si rrjedhoj e kesaje Paneli Shqyrtues i OSHP-së, përmes Vendimit nr. 2026/0498, datë 18.08.2026**,** e ka aprovuar pjesërisht ankesën e EVERGREEN TIMBER SH.P.K. dhe ka urdhëruar korrigjimin e dokumentacionit të prokurimit, duke mbështetur rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues.

Kjo praktikë është drejtpërdrejt relevante për aktivitetin aktual të Komunës së Gjilanit, ku janë vendosur konfigurime të detyrueshme të kamionëve me vinç dhe tonazhe të përcaktuara, pa u paraqitur arsyetim i individualizuar për domosdoshmërinë e tyre.

Edhe pse karakteristikat numerike nuk janë identike në të dy aktivitetet, çështja juridike është e ngjashme: nëse kërkesat teknike për transportin e druve janë objektivisht të nevojshme, proporcionale dhe të lidhura drejtpërdrejt me realizimin e kontratës.

Prandaj, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të marrë në konsideratë Raportin dhe Vendimin nr. 2026/0498 si praktikë relevante, të shqyrtojë arsyetimin teknik të Komunës së Gjilanit dhe, nëse konstaton mungesë proporcionaliteti, të urdhërojë riformulimin e kriterit duke kërkuar **mjete transportuese dhe shkarkuese të mjaftueshme e të përshtatshme për realizimin e furnizimit**, pa karakteristika të detyrueshme që nuk mbështeten me nevoja konkrete teknike.

Pretendmi ankimore 4.

Kërkesa fillestare kërkonte për kompanitë jashtë Gjilanit depo brenda 20–30 km nga administrata ose paramarrëveshje për lokacion në qytet. Në B54, kërkesa e riformuluar kërkon për këto kompani "një punkt – depo" ose paramarrëveshje për lokacion me qira "në qytetin e Gjilanit". Pra hiqet diapazoni kilometrik, por kushti i një depoje në qytet ruhet; është veçanërisht me rëndësi që kjo kërkesë lidhet shprehimisht me kompani jashtë territorit, jo me detyrimin e barabartë për të gjithë.

Një depo jashtë qytetit mund të mundësojë dorëzim brenda afatit të kontratës; një depo brenda qytetit nuk e garanton automatikisht respektimin e afatit. AK nuk ka ofruar analizë të itinerareve, afateve të porosive dhe pikave të shkarkimit që do të provonte domosdoshmërinë e vendndodhjes administrative.
Kërkojmë zëvendësimin me dëshmi të kapaciteteve të furnizimit e transportit, plan logjistik dhe respektim të afatit, pa kushtëzim territorial të operatorit.

SHTJELLIM MBËSHTETËS për pretendimet 2–4 – 8,000 m², paqartësia e kriterit dhe efekti kumulativ


Në B54, kërkesa fillestare "Operatorët Ekonomik ... jo më pak se 8.000 meter katror për tri vitet" ndryshohet në "Operatorët Ekonomik, apo Grupet e OE ... jo më pak se 8.000 meter

katror për tri vitet". Ky ndryshim zgjeron shprehimisht rrethin e subjekteve që mund të përdorin kapacitet të përbashkët; nuk dëshmon vetvetiu favorizim të një grupi të identifikuar. Megjithatë, pragu 8,000 dhe paqartësia e formulimit mbeten. m² mat sipërfaqe, ndërsa m³ mat vëllim të lëndës drusore. Shprehja "për tri vitet" është e paqartë për një stok në një moment të caktuar.

Për dallimin midis kostos së stokut dhe sipërfaqes: vetëm nëse AK nënkupton 8,000 m³ dru të blera e të mbajtura paraprakisht, me çmim supozues 60 €/m³, kapitali i mundshëm është 480,000 € për një OE dhe 2,400,000 € për pesë OE hipotetikë. Kjo nuk është provë se çmimi i tregut është 60 €, se ekzistojnë pesë ofertues, se 90% e tregtarëve nuk i plotësojnë kriteret, apo se 8,000 m² mund të shumëzohet me €/m³. Nëse kriteri ka të bëjë me sipërfaqen e depos, shembulli financiar nuk aplikohet.

Këto rrethana i paraqesim si ilustrim të barrës së kombinuar në organizimin e depos, stafit dhe mjeteve, jo si pretendim të ri të pavarur për anulimin e pragut 8,000, meqë Evergreen nuk e ka kundërshtuar shprehimisht këtë prag në fazën e kërkesës paraprake. I kërkohet OSHP-së të vlerësojë efektin kumulativ në kontekstin e pretendimeve të paraqitura me kohë, duke respektuar nenin 64.2 të Rregullores.

Alternativë më pak kufizuese për gjurmimin e origjinës është dorëzimi, për çdo ngarkesë, i fletëpërcjellëses së Agjencisë Pyjore të Kosovës së bashku me faturën, procesverbalin e pranimit dhe dokumentet e tjera ligjore. Fletëpërcjellësja nuk dëshmon automatikisht stokun paraprak, por dokumenton mekanizmin zyrtar të gjurmimit të një dërgese. Fotografia autentike e paraqitur nga ankuesi, është vendosur më poshtë:



Palës
Stranka
Pedant

Ser. 24

Agjencia Pyjore e Kosovës
Agencija Šumarstva Kosova
Kosovo Forest Agency

03529
007290

DK / KD / CD
AK / OA / MA

FLETËPËRCJELLËSE - OTPREMNICA - WOOD FREIGHTING PERMIT

Për pyjet private - Za privatne sume - For private forests

Emri mbiem. / Ime i prezime / Name and fam. name: Rrecen. H. Azem
Vendi / mesto / place: Tavarnica
KK / SO / Mun.: Rahovec

Ngastra kad. nr. / Kat. parcela br. / Plot-land reg.no.: 853
Data / Dana / Date: 22/10/26 (Data / Muaji / Viti)
Koha e nisjes / Vreme polaska / Departure: 16 (ora / min.)
Koha e arritjes / Vreme dolaska / Arival: 20 (ora / min.)

Nr. Br. No.	Lloji i drurit Vrsta drveta Species	Asortimenti Sortiment Assortment	Njomë/thatë Sirovo/suvo Green/ndry	DIMENSION: D. i mesëm Srednji prec. Cent. diam.	DIMENSION: Gjatësia Duzina Length	DIMENSION: Mbeturina Otpadak Waste	Vëllimi Zapremina Volume
				Cm	m	m	m³
0	1	2	3	4	5	6	7
1.	DRU	DZVP	1	1	1	1	8
2.	PLEP						
3.							
4.							
5.							
6.							
7.							
8.							
9.							
10.							
11.							
12.							
13.							
14.							
15.							
	Gjithsejt: Ukupno: Total:						8

Transportuesi / Autotransporter / Transporter: KUSHTR MAKOLLI
Makina me targë Nr. / Sa kam. Sa pegist. Br. / Vehicle Reg. No.: 07G-[illegible]
Vendbarkimi / Mesto istovara / Destination: DEPO HOTAVA

E pranoi, Primio, Received by:

Damka pyjore, Sumski žig, Forest mark

Personi i autorizuar, Id / Ovlasceno lice, Id / Authorizing officer, Id

.

<u>Pretendmi ankimore 5.</u>

Evergreen ka ngritur çështjen e qëndrimeve të mëparshme të një zyrtari i cili, sipas pretendimit, ka qenë edhe ekspert i angazhuar në çështje tjetër. AK nuk ka verifikuar në arsyetimin e vendimit raportin e referuar, rolin konkret dhe dallimin faktik ndërmjet rasteve.

Nuk pretendojmë se kjo provon konflikt interesi apo favoritizëm të qëllimshëm; kërkojmë vlerësim të argumentit të ngritur në kohë dhe përgjigje të arsyetuar.
Kombinimi i një pragu të madh e të paqartë të depos, kërkesës për depo në qytetin e Gjilanit, minimumit prej 20 punëtorësh dhe konfigurimeve fikse të mjeteve mund të kufizojë konkurrencën dhe t'i japë avantazh objektiv disa strukturave operacionale. Përfundimi se dosja është krijuar për një fitues të caktuar do të kërkonte prova të tjera; ankuesi kërkon analizë të proporcionalitetit dhe ndikimit konkurrues, jo konstatim pa prova për motivin e AK-së.

Prandaj duke u bazuar në faktet, argumentet dhe provat e paraqitura ne këtë ankese kërkojmë nga OSHP, qe te autorizoi ekspert shqyrtues, profesional, te pavarur dhe objektiv i cile ne kuptim te nenit 113 dhe 114 te LPP-se i trajton pretendimet tona ankimore ne mënyrë te pa varur ne atë mënyrë qe Paneli Shqyrtues i OSHP-së të nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. **TË APROVOHET** ankesa jone si e bazuar;
II. **TË RISHQYRTOHET** kërkesa fikse për 20 punëtorë dhe të kërkohet analizë e ngarkesës së punës, me pranimin e kapaciteteve funksionalisht ekuivalente.
III. **TË ANULOHET** kushti territorial i depos në qytetin e Gjilanit, në favor të aftësisë së provueshme për furnizim brenda afatit.
IV. **TË MERRET PARASYSH** si argument mbështetës paqartësia 8,000 m² kundrejt m³ dhe ndikimi i kritereve kumulative, pa e zgjeruar objektin e pretendimeve të paraqitura më parë në AK.
V. **TË ADMINISTROHET** fletëpërcjellësja e APK-së, si provë ilustruese e gjurmimit të ligjshëm për çdo ngarkesë; TË VLERËSOHET kjo alternativë e kontrollit gjatë furnizimit.
VI. **TË VERIFIKOHET** vetëm nëse mbetet në dosjen përfundimtare kriteri i licencës pyjore; në rast se është larguar, të mos trajtohet si shkelje e mbetur.
VII. **TË OBLIGOHET - AK** , qe te largoi kerkesat dhe kriteret diskriminuese dhe te nxjerre njoftim mbi korrigjimin e gabimit ashtu siç parashifet me nenin 53.7 te LPP-se dhe te behet zgjatja e afatit për ofertim.
VIII. **TE LEJOHET, kthimi i mjeteve te deponuara ne emer te ankese.**

Egzistone baze ligjore dhe prova materiale për procedim tutje dhe deponim te kesaje dosje ne instanca ligjzbatuese, pasi qe kriteret e tilla tregoin se AK – Komuna Gjilan këtë procedure te prokurimit e ka kurdisur për kompani e cila operon ne teritorin e komunes se gjilanit dhe lejimi i procedimit te aktiviteitit me kerkesa te tilla apo lejimi i lidhjes eventuale te kontrastes neve si kompani na obligon qe këtë dose ta deponojme ne prokurorine perkatese...

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ankuesi mund të pësojë kosto të panevojshme për mbajtjen e kapaciteteve të imponuara, përgatitjen e ofertës dhe përdorimin e mjeteve juridike, si dhe humbje të mundësisë së konkurrimit në kushte të barabarta. Nuk kërkohet kompensim i një shume të pavërtetuar;

shembulli financiar në seksionin 7 është ilustrues, jo llogaritje e dëmit të Evergreen Timber SHPK.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*